

VENDIM
Nr. 532, datë 13.6.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 16.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL, PËR VITIN 2013”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4.23 të vendimit nr. 89, datë 16.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4.24, me këtë përmbajtje:

“4.24. Për kompensimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për makineritë bujqësore dhe konstruktionet e serrave, bazuar në faturën e blerjes me TVSH.

Kriteret, procedura e kompensimit dhe lista e makinerive dhe pajisjeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

2. Efektet financiare të këtij kompensimi përballohen nga buxheti i vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha